



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 31 , Datë 26 / 01 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.109 Regj., datë 08.08.2017, të znj.E. S, kundër Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.E. S në ankesën e saj shprehet se: *“Jam një nënë 51 vjeçare, me gjashtë fëmijë, dy prej të cilëve me probleme shëndetësore. Jetoj në një apartament me një dhomë e kuzhinë, ndërtesë e Entit Kombëtar të Banesave. Nuk kam mundësi të paguaj rregullisht detyrimet ndaj Entit Kombëtar të Banesave. Kjo gjë bën që të rrezikoj të dal në mes të katër rrugëve së bashku me familjen time. Të ardhurat e familjes janë vetëm dy kempet që marrin fëmijët e mi. Në apartament jetojmë 13 frymë së bashku me djemtë, nuset dhe fëmijët e tyre. Paguaj çdo muaj 13.000 mijë lekë të rinj por kjo tarifë është shumë e lartë për t’u përballuar. Unë jam vetë burrë e vetë grua, fëmijët i kam rritur me sakrificë të mëdha. Dy prej tyre kanë*

¹ Subjekti ankues i përket komunitetit rom/egjiptian.

probleme shëndetësore, janë edhe me prapambetje mendore. Ngrysemi dhe gdhihemi pa ngrënë pasi të ardhurat që marrim nga kempit nuk na dalin për ushqim. E vetmja gjë e mirë që më ka ndodhur në jetë është përfitimi si e pastrehë e apartamentit ku jetoj aktualisht, sepse unë kam jetuar në rrugë gjatë gjithë atyre viteve, dhe tani rrezikoj sërish të kthehem në rrugë”.

Subjekti ankues pretendon se diskriminohet nga ana e EKB Korçë për shkak të racës së saj. Në përfundim të ankesës znj.S kërkon që të mos nxirret nga shtëpia si pasojë e mospagesës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

² Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.815/1 prot, datë 14.08.2017, Komisioneri i kërkoi informacion Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë³, mbi pretendimin e ngritur nga znj.S.
- Me shkresën me nr.135/1 prot., datë 21.08.2017, DREKB Korçë ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

DREKB Korçë ka sqaruar se, në zbatim të ligjit dhe të politikave të strehimit për kategoritë e të pastrehëve kanë lidhur kontrata shit-blerje me kusht për disa apartamente, pronë të saj, ndër të cilat në vitin 2007 është lidhur edhe kontrata me qytetaren E. S.

DREKB Korçë informon se: *“Nga ana e palës kontraktore nuk është përmbushur detyrimi thelbësor i kontratës që është pagesa në mënyrë të rregullt dhe periodike e kësteve mujore të kredisë. EKB pasi ka ezauruar të gjitha rrugët administrative (njoftime shkresërisht në banesë, takime etj) është detyruar të veprojë në rrugë gjyqësore duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr.3058, datë 07.12.2012, ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë së EKB-së për zgjidhje të kontratës, lirimin dhe dorëzimin e apartamentit nga qytetarja dhe familja e saj. Gjithashtu është nxjerrë dhe Urdhër ekzekutimi përkatës nr.614, datë 18.09.2014 i po kësaj gjykate. Në rastin e ankueses ashtu si dhe në gjithë rastet e tjera është ndjekur:*

- *Përdorimi i kontratës tip⁴.*
- *Manuali i politikave dhe procedurave të menaxhimit të debitorëve, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së.*

Pra, kontrata e nënshkruar midis EKB-së dhe znj.E. S është njëlloj me të gjitha kontratat e tjera që EKB ka me klientët e tjerë si dhe procedura e ndjekur në rastin konkret është konform manualit të menaxhimit të debitorëve. Raste të tjera të ngjashme me klientët debitorë janë finalizuar me lirimin e banesës nga qytetari⁵. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, edhe pas nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit, EKB ka patur dhe ofruar gjithë predispozicionin për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike, por nga ana e qytetares nuk është ofruar asnjë mundësi

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DREKB Korçë.

⁴ Kontrata “Tip” është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së.

⁵ Rasti i qytetarëve Petro Lluka dhe Gurije Shkoza

bashkëpunimi në funksion të zgjidhjes së situatës. Në këto kushte EKB nuk mund t'i ofrojë ndihmë qytetares, e cila ligjërisht është e detyruar të lirojë banesën”.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 09.10.2017⁶, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të DREKB Korçë.

Referuar procesverbalit të datës 09.10.2017, mbajtur nga inspektorët e KMD-së, pasqyrohet situata si më poshtë cituar: “...Grupi i inspektimit të Komisionerit u paraqit pranë ambjenteve të këtij institucioni por aty nuk kishte asnjë punonjës të pranishëm. Dera ishte e mbyllur me çelës. Kjo gjë vijoi nga ora 13⁰⁵-14¹⁰. Në pamundësi të realizimit të inspektimit, inspektorët evidentuan faktin dhe mbajtën procesverbal, duke pasqyruar këtë fakt ”.

3. Në këto kushte, me shkresën me nr.515/5 prot., datë 20.10.2017 iu kërkua sërish informacion DREKB Korçë.

Me shkresën me nr.177/1 prot., datë 23.10.2017 DREKB Korçë, solli argumentimet e veta dhe dokumentacion bashkëlidhur për sa ishte kërkuar nga Komisioneri.

4. Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sipas nenit 33, pika 8, me datë 10.11.2017, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve.⁷

Seanca u zhvillua me praninë e të dyja palëve. DREKB Korçë u përfaqësua nga Drejtori, z.K, i cili theksoi faktin që nga ana e këtij institucioni ka patur dhe ka predispozicion për të ndihmuar ankuesen, por zonja nuk ka shfaqur vullnet për të bashkëpunuar. Znj.S dhe familjarëve të saj në moshë madhore u është ofruar mundësi punësimi, që të mund të rrisnin të ardhurat financiare në mënyrë që të shlyenin dhe këstet e detyrueshme, por ata e kanë refuzuar. Z.K informon se në asnjë rast zonja nuk është trajtuar ndryshe apo në mënyrë të pafavorshme krahasuar me debitorët e tjerë, pasi lidhur me pretendimin e saj për kthimin e grantit 10% në buxhetin e shtetit, kjo ka ndodhur për shkak se znj.S është më kontratë të zgjidhur me EKB Korçë. Kjo gjë ka ndodhur dhe me 2 persona të tjerë, të cilët po ashtu kanë patur kontratë të zgjidhur me EKB Korçë, dhe ka ardhur si rezultat i kësaj të fundit dhe jo për shkak të racës së zonjës.

⁶ Në zbatim të Urdhërit nr.119, datë 05.10.2017, të Komisionerit.

⁷ Në zbatim të shkresës me nr.1081 prot, datë 01.11.2017, të Komisionerit.

Znj.S u shpreh se pretendimi i saj ndaj EKB Korçë, është se asaj i është refuzuar falja prej 10% me arsyetimin se ka kontratë të zgjidhur me këtë institucion, ndërsa 2 personave të tjerë, dhe ato me kontratë të zgjidhur, u është ofruar granti 10%. Zonja u shpreh se nuk është 100% e sigurtë për këtë pohim, megjithatë do të interesohet dhe do kthejë përgjigje pranë KMD-së lidhur me emrat e personave.

Përfaqësuesi i EKB Korçë, z.K hodhi poshtë këtë pretendim duke i kërkuar zonjës të paraqiste emra konkret, pasi ai thekson se në asnjë rast nga EKB Korçë nuk është miratuar granti për familjet që rezultojnë me kontratë të zgjidhur.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga DREKB Korçë, për shkak të races.

Në zbatim të dispozitave përkatëse ligjore dhe të politikave të strehimit për kategoritë e të pastrehëve, në vitin 2007, Drejtoria Rajonale Korçë e Entit Kombëtar të Banesave ka lidhur kontrata shitblerjeje me kusht, për disa apartamente në pronësi të saj me disa qytetarë që i përkasin komunitetit egjiptian, por edhe të maxhorancës, ndër të cilët edhe me qytetaren E. S. Duke qenë se nga ana e familjes S nuk janë përmbushur detyrimet kontraktore, që konsistojnë në pagimin në mënyrë të rregullt dhe periodik të kësteve mujore të përcaktuara në kontratë, (sikurse edhe disa familje të tjera) kjo familje është paditur në gjykatë nga Drejtoria Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë. Me vendimin gjyqësor nr.3058, datë 07.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur zgjidhja e kontratës së znj.Sefa me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, si dhe lirimi dhe dorëzimi i apartamentit nga familja S. Gjithashtu, është nxjerrë edhe Urdhëri i Ekzekutimit nr. 614, datë 18.09.2014, për zbatim pranë Zyrës Përmbartimore Korçë.

Pavarësisht sa më sipër, znj.S nuk është detyruar të lirojë e dorëzojë banesën e saj dhe të jetë kontigjent e të pastrehëve, pasi Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Korçë, për të

evituar një gjë të tillë, nëpërmjet shkresës nr. 263/1, datë 06.01.2014, i ka kërkuar Zyrës Përmbartimore Korçë pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për një afat të pacaktuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit, rezulton se, edhe pas nxjerrjes së Urdhër-ekzekutimit, EKB është treguar e gatëshme për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike, por nga znj.S nuk është ofruar asnjë mundësi bashkëpunimi në funksion të zgjidhjes së situatës. Kështu, me shkresën me nr.265 prot., datë 05.11.2014 EKB Korçë ka njoftuar ankuesen të paraqitej pranë zyrave të saj, për të negociuar për një strukturim të mundshëm të shlyerjes së kredisë. Theksojmë se nuk ka patur asnjë reagim pozitiv nga ana e znj.S, referuar kërkesës së EKB Korçë.

Po ashtu, vlen të theksojmë se, EKB Korçë ka vijuar përpjekjet për të mundësuar që familjet në nevojë që rezultojnë të jenë dhe debitore në shlyrjen e kredive pranë këtij institucioni, të mund të realizojnë pagesat nëpërmjet punësimit të tyre.

Kështu, nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi me Zyrën Rajonale të Punësimit Korçë dhe Bashkinë Korçë, kanë ngritur një grup pune i cili kishte për qëllim verifikimin e pjesëtarëve në moshë madhore dhe të aftë për punë, kryesisht në familjet që janë debitorë potenciale ndaj EKB-së.

Referuar procesverbalit të datës 06.06.2016 janë verifikuar në banesë 9 (nëntë) familje, ndër të cilat edhe familja e znj.S. Në procesverbal pasqyrohet fakti se, në familjen e znj.S janë konstatuar të aftë për punë: znj.S (51 vjeç), A (25 vjeç) dhe Z. B (26 vjeç). Propozimi i grupit të punës ishte që këta persona duhet të paraqiten pranë zyrës së punësimit për t'u regjistruar si punëkërkues dhe të njihen me ofertat e kësaj zyre.

Me shkresën me nr.1071 prot., datë 09.06.2016 EKB Korçë ka njoftuar tre pjesëtarët e familjes Sefa, sipërcituar, të paraqiten brenda një jave pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Korçë, për të marrë shërbimin e kësaj zyre në drejtim të ofrimit të një vendi pune ose orientimin drejt një kursi profesional, me qëllim që të mund të siguronin të ardhura për të përballuar strehimin e tyre.

Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar mes EKB dhe Zyrës Rajonale të Punësimit Korçë, me shkresën me nr.454 prot., datë 20.07.2016 Zyra e Punësimit ka informuar EKB-në se A. S dhe Z. B (pjesëtarë të familjes S) nuk ekzistojnë të regjistruar si punëkërkues të papunë, pranë zyrës së tyre.

I njëjti informacion është përcjellë edhe pas një muaji, me shkresën me nr.569 prot., datë 25.08.2016, ku sërish ata nuk ekzistojnë të regjistruar si punëkërkues të papunë.

Sa i takon pretendimit të znj.S për detyrimin e saj nga EKB për kthimin e grantit të menjëhershëm 10%, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e EKB Korçë, për arsyen e se ajo nuk legjitimohet për përfitimin e këtij bonusi, në kushtet kur kontrata e tij me EKB Korçë është zgjidhur gjyqësisht. Nga ana tjetër, nga verifikimet e dokumentacionit të sjellë nga EKB Korçë, rezulton se në të njëjtën mënyrë janë trajtuar edhe personat e tjerë, të cilët rezultojnë me kontratë të zgjidhur me EKB Korçë. Citojmë praktikën e depozituar në dosjen e ankueses nga EKB Korçë:

- Shkresa me nr.138/1 prot., datë 23.08.2017 “Për kthimin e grantit të menjëhershëm në Buxhetin e Shtetit”, drejtuar znj.V. M, e cila rezulton me kontratë të zgjidhur me EKB-në.
- Shkresa me nr.138/2 prot., datë 23.08.2017 “Për kthimin e grantit të menjëhershëm në Buxhetin e Shtetit”, drejtuar znj.K. R, e cila rezulton me kontratë të zgjidhur me EKB-në.

Theksojmë gjithashtu faktin se, ankuesja nuk solli, pavarësisht pretendimeve të ngritura gjatë seancës dëgjimore, asnjë dokument, provë apo të dhënë, lidhur me emra konkret, për të provuar se personave të ndodhur në situatë të njëjtë me të, u është aprovuar përfitimi i grantit të menjëhershëm 10%.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se znj.E. S nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.

B. Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga subjekti ankues.

“Raca” është njëri nga shkaqet, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin*

gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Lidhur me pretendimin e znj.S për diskriminim për shkak të racës, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, Komisioneri thekson faktin se zonja është krahasuar me familje të tjera që nuk i përkasin komunitetit egjiptian dhe që ndodhen në të njëjtat kushte me të: me kontratë të zgjidhur me EKB Korçë dhe që vijojnë të jenë debitorë ndaj këtij institucioni. Citojmë këtu rastet e z.K.Ll dhe E.Sh, praktikat e të cilëve janë depozituar pranë Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se zonja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga EKB Korçë. Biles, theksojmë faktin se familja e zonjës është favorizuar nga ky institucion, parë kjo dhe në këndvështrim krahasues me personat sipërcituar, të cilët kanë qenë me kontratë të zgjidhur me EKB-në dhe nga ana e Zyrës Përmbartimore Korçë është bërë ekzekutimi i vendimit gjyqësor për lirim të banesës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e mosdiskriminimit për shkak të racës së ankueses, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.

Nëpërmjet korrespondencës zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë, ky institucion ka theksuar faktin se qëllimi i tij i vetëm ka qenë ka qenë ndihma për t'i siguruar znj.S mundësinë për të shlyer kredinë dhe për të patur banesën e saj, duke shmangur detyrimin e saj për të liruuar dhe dorëzuar banesën që prej vitit 2104, pas zgjidhjes gjyqësisht të kontratës së shitjes me kusht dhe daljes së urdhërit të ekzekutimit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës të znj.E. S, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Korçë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: raca)

(fusha: të mira dhe shërbime)